



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1330/2prot.,

Datë 09.06.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-67235-04-26-2023, me objekt: “Blerje materiale pastrimi dhe detergjentë” me fond limit 4878534 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Ankimues: “EURO MEGA 2010” SHPK
Fshati Ahemtaq, pranë firmës Ital Kon Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Fier
Lagjja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15, Fier

Në datën 08.06.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1330/2023 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3168e operatorit ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-67235-04-26-2023, me objekt: “Blerje materiale pastrimi dhe detergjentë” me fond limit 4878534 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga “EURO MEGA 2010” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1330prot.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Bazuar në deklarin e bërë në Formularin përmbledhës së vetdeklarimit Shtojca 8 nga O.E Euro konkretisht Deklaratën “ Pjesa II : Shkaqet e përjashtimit A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TE PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT “ , në respektim të pikës 2 gërma (ç) të nenit 26 “ Formulari përmbledhës I vetdeklarimit “ , të VKM Nr.285 , datë 19/05/2021 (të ndryshuar) Komisioni I vlerësimit të ofertave pas verifikimeve të deklarimeve të bera si moment procedural në zbatim të përcaktimeve ligjore për Autoritetin kontraktor se “ Në cdo rast , autoriteti /enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër , ose ti kërkojë operatorit sqarime dhe dokumentacione mbështetëse për këto sqarime “ bazuar në pikën 7 të nenit 26 të VKM Nr.285 , datë 19/05/2021 (të ndryshuar) pasi kreu verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga O.E euro me shkresën zyrtare Nr.4178/Prot , datë 15/05/2023 “ drejtuar Drejtorisë së Burgjeve për verifikimin e gjendjes gjyqësore dhe dërgim informacioni për H.SH ne cilesine e ortakut të O.E EuroMega .

Me shkresën nr.6321/1 Prot , datë 19/05/2023 , protokuolluar pranë A.K Bashkia Fier më nr.4178/1 Prot , datë 23/05/2023 , lënda “ Kthim pergjigje” nga Drejtoria e Pergjithshme te Burgjeve bashkëlidhur së cilës vërtetimi i gjendjes gjyqësore nr. 11 , datë 18/05/2023 rezultoi se H.Sh ka qënë i dënuar me Vendim gjykate të Formës së Prerë nr.1553 date 02.06.2022 te Gjykates Te Rethit Gjyqesor Tirane për veprën penale “prodhim të kundraligjshëm të artikujve dhe mallrave industriale dhe ushqimore”

Sa me larte duke qene se nga O.E është paraqitur deklarim i pavërtetë për deklarimin sipas pikës 3 gërma c të nenit 76 të LPP , kjo përbën shkak për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit .

Këto arsye përbëjnë shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik.

- Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 09.06.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Nënkryetar

Fiorent Zguro

Kryetar

Jonaid Myzyri